

Banka e Shqipërisë

LLOGARITË FINANCIARE TË SHQIPËRISË 2024

Departamenti i Statistikave Financiare, Banka e Shqipërisë.

PËRMBAJTJA

1.	<i>Çfarë janë llogaritë financiare?</i>	4
2.	<i>Mjetet dhe detyrimet financiare të sektorëve institucionalë</i>	6
3.	<i>Zhvillimet sipas sektorëve institucionalë</i>	9
3.1	<i>Ekonomitë familjare</i>	9
3.2	<i>Korporatat jofinanciare</i>	10
3.3	<i>Qeveria e përgjithshme</i>	12
3.4	<i>Korporatat financiare</i>	14

1. ÇFARË JANË LLOGARITË FINANCIARE?

Llogaritë Financiare Kombëtare (në vijim "llogaritë financiare") janë një nga komponentët e llogarive kombëtare dhe mund të përshkruhen si një grup i strukturuar dhe koherent informacioni statistikor, i cili regjistron transaksionet financiare - flukse dhe stoge - midis sektorëve të ndryshëm institucionalë të ekonomisë, si dhe ndërmjet këtyre sektorëve dhe pjesës tjetër të botës, të ndara sipas llojeve të ndryshme të instrumenteve financiare. Matricat "nga kush – te kush", të prodhuara si pjesë e llogarive financiare, paraqesin marrëdhëniet ndërsektoriale mbi bazën e instrumenteve financiare si huatë, depozitat dhe letrat me vlerë, duke ofruar tregues mbi mënyrën si shpërndahen burimet nëpër sektorë.

Llogaritë financiare ofrojnë informacion të plotë mbi operacionet dhe strukturën e ndërmjetësimit financiar në vend, si dhe tregojnë kanalet kryesore të përdorura për të përfutur dhe investuar zotërimet financiare. Kjo statistikë është një burim i rëndësishëm informacioni për analiza të politikës monetare dhe stabilitetit financiar.

Hartimi i llogarive financiare në Bankën e Shqipërisë bazohet në udhëzimet e përcaktuara në metodologjinë e sistemit evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale (ESA 2010). Manuali ESA2010 (Sistemi Evropian i Llogarive) është një standard ndërkombëtar që shërben për hartimin e statistikave të llogarive financiare, për të gjitha vendet në Evropë¹.

Disa nga përkufizimet dhe klasifikimet kryesore të përdorura në llogaritë financiare janë:

- **Ekonomia vendase (rezidentët)** - përfshin të gjithë sektorët rezidentë – korporatat jofinanciare, korporatat financiare, qeverinë e përgjithshme, ekonominë familjare dhe institucionet jofitimprurëse në shërbim të familjeve;
- **Pjesa tjetër e botës (jorezidentët)** - përfshin të gjithë personat fizikë dhe juridikë që banojnë jashtë vendit për më shumë se një vit. Në kuadrin e llogarive financiare, ky sektor tregon aktivet dhe detyrimet që pjesa tjetër e botës zotëron përmes marrëdhënieve financiare me rezidentët;
- **Stoku** - përfaqëson nivelin e aktiveve dhe detyrimeve financiare në fund të çdo periudhe;
- **Fluksi (ndryshimi periodik)** - tregon ndryshimin në stok midis periudhave raportuese, të ndarë sipas transaksioneve dhe ndryshimeve të vlerësimit;
- **Transaksioni** - llogaritet duke zbritur efektet e vlerësimit (që vijnë nga ndryshimet në kursin e këmbimit dhe çmime) nga fluksi i përllogaritur

¹ Më gjerësisht, metodologjia shpjegohet në botimin e Bankës së Shqipërisë "Llogaritë financiare sektoriale: Shënime metodologjike".

për një periudhë të caktuar, dhe tregon ndryshimet neto të rregulluara midis dy periudhave;


- **Të konsoliduara / të pakonsoliduara -**
 - o në të dhënat e konsoliduara, marrëdhëniet financiare netohen brenda sektorëve dhe nënsektorëve,
 - o në të dhënat e pakonsoliduara, të gjitha transaksionet shfaqen në mënyrë bruto,
 - o sektori i pjesës tjetër të botës është i vetmi që nuk i nënshtrohet konsolidimit;

- **Pasuria neto financiare (pozicioni neto financiar) -** llogaritet duke zbritur detyrimet totale nga aktivet totale financiare (stoku).
 - o Një vlerë pozitive tregon se sektori është kreditor neto,
 - o ndërsa një vlerë negative tregon se është debitor neto;

- **Huadhënës neto / huamarrës neto -** llogaritet duke zbritur përdorimin e financimit të jashtëm nga përvetësimi i aktiveve financiare.
 - o Një vlerë pozitive tregon se sektori është huadhënës neto,
 - o ndërsa një vlerë negative tregon se është huamarrës neto.

2. MJETET DHE DETYRIMET FINANCIARE TË SEKTORËVE INSTITUCIONALE

Totali i mjeteve financiare të sektorëve të brendshëm të ekonomisë (sektorëve rezidentë), në vitin 2024, vlerësohet në 8,596.6 miliardë lekë, në rritje vjetore me 5.1%. Totali i detyrimeve u zgjerua po ashtu me 5.1% në terma vjetorë, në nivelin 9,640 miliardë lekë. Në dimensionin e ekspozimit neto², ekonomia shqiptare, në fund të vitit 2024, pozicionohet në huamarrës neto me rreth -1044³ miliardë lekë. Ky nivel është rreth 5.8% më i lartë krahasuar me pozicionin prej -987 miliardë lekësh në vitin 2023.



Tabelë 1. Stoku i mjeteve financiare dhe detyrimeve të sektorëve institucionalë, 2024, Në miliardë lekë

	Korporatat jofinanciare	Korporatat financiare	Qeveria e përgjithshme	Ekonomitë familjare
Mjete financiare				
Ari monetar dhe SDR	0	49	0	0
Monedha dhe depozita	442	522	174	1,451
Letra me vlerë të borxhit	24	1,400	0	108
Hua	116	1,015	54	3
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	160	62	224	1,244
Rezervat teknike	24	7	0	11
Derivatët financiarë	0	0	0	0
Llogari të tjera të arkëtueshme	1,166	31	160	147
Totalë	1,932	3,087	613	2,964
Detyrime				
Ari monetar dhe SDR	0	-22	0	0
Monedha dhe depozita	0	-2,497	0	0
Letra me vlerë të borxhit	-22	-23	-922	0

² Diferenca mes mjeteve dhe detyrimeve financiare.

³ Në përputhje me metodologjinë, ka një diferencë midis pozicionit financiar neto të ekonomisë së vendit dhe pozicionit financiar neto të sektorit jorezident, meqenëse ari monetar nuk ka kundërparti dhe regjistrohet vetëm si mjet i bankës qendrore.

Hua	-808	-139	-344	-372
Kapitali dhe aksione në fonde investimi	-2,562	-326	0	0
Rezervat teknike	0	-37	0	0
Derivatët financiarë	0	0	0	0
Llogari të tjera të pagueshme	-1,193	-33	-272	-68
Totali	-4,585	-3,077	-1,538	-439

¹ Zero absolute, zero e rumbullakosur ose vlerë e papërfillshme


- Jo e aplikueshme

.. Mungon informacioni

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për sa i përket ndërlidhjeve sektoriale, ekonomitë familjare dhe sektori jorezident pozicionohen në kreditorë ose huadhënës neto, ndërkohë që korporatat jofinanciare dhe qeveria e përgjithshme vijojnë në pozicion debitor ose huamarrës neto⁴. Për shkak të natyrës së biznesit, korporatat financiare shfaqin një pozicion neto shumë të ulët.

Sektori financiar, sektori korporata jofinanciare dhe ai jorezident evidentohen si sektorët kryesorë për sa i përket ekspozimit bruto⁵ (vektorët më të theksuar).



Gjithashtu, shkalla e integritimit me jashtë (segmenti lidhës me sektorin jorezident) paraqitet e lartë për korporatat financiare, me një total të ekspozimit bruto prej 1,437 miliardë lekësh, rrjedhojë e investimeve në letra me vlerë, marrëdhënieve ndërbankare, depozitave të emigrantëve, si dhe pjesëmarrjes së huaj të kapitalit në sektorin bankar. I ilustruar me të dhënat në paraqitjen e llogarive financiare sipas matricës “nga kush – te kush”, ekspozimi bruto i sektorit të korporatave financiare me jashtë (jorezidentët) përllogaritet si shumator i mjeteve (1034) dhe detyrimeve (404) të korporatave financiare me jorezidentët (Tabela 2).

⁴ Më gjerësisht, analiza e zhvillimeve të llogarive financiare për çdo sektor në seksionin 4.

⁵ Totali i mjeteve dhe detyrimeve financiare me sektorë të tjerë.

Tabelë 2. Paraqitja e llogarive financiare në matricën “nga kush - te kush” - viti 2024, në miliardë lekë


		Sektori kreditor				
		Korporatat jofinanciare	Korporatat financiare	Qeveria e përgjithshme	Ekonomitë familjare	Jorezidentët
Sektori debitor	Korporatat jofinanciare	966.47	524.45	442.78	1,184.80	1,466.08
	Korporatat financiare	383.25	360.89	169.78	1,297.07	404.17
	Qeveria e përgjithshme	271.15	696.08	-	94.82	475.81
	Ekonomitë familjare	61.12	378.35	-	-	-
	Jorezidentët	120.41	1,033.78	-	94.30	-

Burimi: Banka e Shqipërisë.

3. ZHVILLIMET SIPAS SEKTORËVE INSTITUCIONALË

3.1 EKONOMITË FAMILJARE⁶

Ekonomitë familjare zotërojnë rreth 34% të totalit të mjeteve financiare të brendshme. Në harkun kohor të një viti, mjetet e këtij sektori u zgjeruan me rreth 180 miliardë lekë dhe, në fund të 2024, shënojnë 2,964 miliardë lekë. Mjetet financiare të ekonomive familjare tejkalojnë ndjeshëm detyrimet e këtij sektori. Instrumenti kryesor i përdorur nga ekonomitë familjare vijon të jetë “monedha dhe depozitat”, i cili përfaqëson 49% të mjeteve financiare të këtij sektori, në fund të 2024. Ndërkohë “kapitali dhe aksione në fonde investimi” përbën 42% të totalit të mjeteve financiare.




Detyrimet e ekonomive familjare përbëhen kryesisht nga kreditë hipotekare, të cilat zënë peshën më të madhe të totalit (rreth 65%), ndjekur nga kreditë konsumatore dhe huatë e tjera.


Detyrimi në “hua” i ekonomive familjare, në fund të vitit 2024, u zgjerua me 42 miliardë lekë dhe shënon vlerën e 371 miliardë lekëve. Detyrimi në “hua” ndaj sektorit të korporatave depozituese, përveç bankës qendrore (bankave të nivelit të dytë), u rrit me 40 miliardë lekë, në nivelin e 323 miliardë lekëve, ndërsa “huatë” me institucionet e tjera financiare u zgjeruan me 3 miliardë lekë, në nivelin e 47 miliardë lekëve.

⁶ Përfshirë institucionet joqytetërore që u shërbejnë familjeve (NPISH), të tilla si organizatat e ndihmës sociale, kishat, sindikatat, partitë politike dhe klubet argëtuese, të cilat u ofrojnë familjeve shërbime jotregu. Mjetet dhe detyrimet financiare të NPISH vlerësohen në më pak se 1% të totalit të aktiveve financiare dhe detyrimeve të ekonomisë familjare. Kur interpretohen të dhënat për mjetet financiare të këtij sektori duhet të konsiderojmë se të dhënat ekonomike janë në nivel të agreguar. Llogaritë financiare nuk disponojnë informacion në lidhje me mjetet financiare individuale të familjeve apo shpërndarjen e pasurisë brenda sektorit.

Grafik 5. Detyrime të ekonomive familjare: hua




Grafik 6. Huaja sipas qëllimit 2024



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 7. Detyrimet e ekonomive familjare: ndryshimi i stokut të huasë





Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.2 KORPORATAT JOFINANCIARE

Detyrimet e korporatave jofinanciare (ose ndryshe bizneset) janë dukshëm në nivel shumë më të lartë se mjetet e tyre. Kjo për arsye se mjetet jofinanciare nuk raportohen në llogaritë financiare. Për më tepër, krahas huave dhe letrave me vlerë të borxhit, detyrimet përfshijnë edhe aksionet e emetuara nga korporatat. Në fund të vitit 2024, korporatat jofinanciare zotërojnë rreth 1,932 miliardë lekë mjete financiare, shifër e cila përbën rreth 22.5% të totalit të mjeteve të brendshme financiare. Mjetet financiare të korporatave jofinanciare janë në masën 23% në “monedha dhe depozita”, ndjekur nga “aksione dhe kapital tjetër” 8% dhe “hua” 6%. Instrumenti “llogari të tjera të arkëtueshme” është vlerësuar në rreth 60% të totalit të aktiveve financiare të korporatave jofinanciare. Ky zë, krahas kredive tregtare, regjistron edhe pretendime të tjera përkundrejt sektorëve të lidhur.


Investimet e sektorit në “monedha dhe depozita” u rritën me 6.3 miliardë lekë, në nivelin 443 miliardë lekë në fund të vitit 2024. Mjetet financiare në formën e “huasë” u rritën me 2.3 miliardë lekë, në nivelin 116 miliardë lekë. Investimet në “aksione dhe kapital tjetër” u rritën me 14 miliardë lekë, në nivelin 160 miliardë lekë.




Në fund të vitit 2024, struktura e detyrimeve të korporatave jofinanciare paraqitet si në vijim: “aksione dhe kapital tjetër” (56%), “llogari të tjera të pagueshme” (26%), “huatë” (18%) dhe “letra me vlerë të borxhit” (1%). Detyrimet në “aksione dhe kapital tjetër” janë kryesisht me investitorët e huaj dhe ekonominë familjare, përkatësisht në masën 46% dhe 41%.

Megjithëse luhatja e kursit të këmbimit të Lekut ndaj valutave të huaja ka qenë në kah të kundërt, detyrimet në “hua” të korporatave jofinanciare pësuan rritje të ndjeshme gjatë vitit 2024, duke shënuar vlerën e 808 miliardë lekëve.

Grafik 12. Detyrime të korporatave jofinanciare, stoku i huasë



Grafik 13. Detyrime të korporatave jofinanciare, ndryshimi i stokut të huasë




Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.3 QEVERIA E PËRGJITHSHME


Të dhënat e sektorit të qeverisë së përgjithshme bazohen në informacionin e raportuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe nga të dhënat kundërpartit. Ky sektor paraqet të dhënat e konsoliduara për nënsektorin e qeverisë qendrore, nënsektorin e qeverisë lokale, dhe fondet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore⁷.

Mjetet financiare në zotërim të qeverisë së përgjithshme vlerësohen në 613 miliardë lekë, në fund të vitit 2024, ose 7% të totalit të sektorëve të brendshëm të ekonomisë. Në terma vjetorë, ato u rriten me 6%.

Grafik 14. Mjete të qeverisë së përgjithshme




Grafik 15. Detyrime të qeverisë së përgjithshme




Burimi: Banka e Shqipërisë.

⁷ Të dhënat e llogarive financiare të sektorit të qeverisë së përgjithshme përfshijnë kryesisht të dhënat e njësive buxhetore, kjo për të ruajtur harmonizimin me statistikat e tjera si llogaritë kombëtare, statistikat financiare të qeverisë (GFS) etj. Nga njësitë ekstrabuxhetore është përfshirë në të dhënat e qeverisë vetëm Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD).

Grafik 16. Përbërja e mjeteve financiare të qeverisë së përgjithshme, 2024




Grafik 17. Përbërja e detyrimeve të qeverisë së përgjithshme, 2024




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2024, detyrimet e qeverisë së përgjithshme vlerësohen në nivelin 1,538 miliardë lekë. Më shumë se gjysma e detyrimeve (60%) përbëhet nga "letrat me vlerë të borxhit". Stoku i "letrave me vlerë të qeverisë" përlllogaritet në rreth 922 miliardë lekë⁸, nga 897 miliardë në fund të vitit 2023. Financuesi kryesor i borxhit të qeverisë së përgjithshme (hua dhe letra me vlerë) është sektori i korporatave financiare, i cili mban rreth 55% të totalit, pasuar nga sektori i jorezidentëve në rreth 38%.

Grafik 18. Detyrime të qeverisë së përgjithshme: letra me vlerë



Grafik 19. Detyrime të qeverisë së përgjithshme: ndryshimi i stokut të letrave me vlerë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

⁸ Në mungesë të informacionit mbi vlerën e tregut, vlera e stokut të letrave me vlerë të qeverisë së përgjithshme për letrat me vlerë të tregtuara në tregun e brendshëm është vlerësuar në vlerë nominale (çmimi i emetimit plus interesat e përlllogaritura), si një përafrim më i saktë i vlerësimit për vlerën e tregut të këtij instrumenti.


3.4 KORPORATAT FINANCIARE

Mjetet financiare të korporatave financiare, në fund të vitit 2024, shënojnë 3088 miliardë lekë dhe përfaqësojnë në masën 36% totalin e mjeteve të brendshme financiare të Shqipërisë.


Sektori i korporatave financiare përbëhet nga nënsektorët: banka qendrore (24%), korporata depozituese përveç bankës qendrore (69%), fondet e investimit (2%), shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit (2%), si dhe institucionet e tjera financiare (4%).

Në masën më të madhe, zotërimet financiare të sektorit të korporatave financiare janë në formën e investimeve në "letra me vlerë të borxhit", me rreth 45% të totalit të mjeteve financiare në fund të vitit 2024. Zotërimet në "hua" dhe "monedha e depozita", gjithashtu zënë një pjesë të konsiderueshme të totalit të mjeteve financiare të këtij sektori, përkatësisht me 33% dhe 17%.

Në krahun e detyrimeve, instrumenti kryesor është "monedha e depozita", në rreth 81% të totalit. Detyrimet në "kapital e aksione në fonde investimi" zënë 11% të totalit të detyrimeve të korporatave financiare.




Grafik 22. Përbërja e mjeteve financiare të korporatave financiare, 2024



- Ari monetar dhe SDR 2%
- Monedha dhe depozitat 17%
- Letra me vlerë të borxhit 45%
- Huatë 33%
- Kapitali dhe aksionet në fondet e investimit 2%
- Llogari të tjera të arkëtueshme 1%

Grafik 23. Përbërja e detyrimeve të korporatave financiare, 2024



- Ari monetar dhe SDR 1%
- Monedha dhe depozitat 81%
- Letra me vlerë të borxhit 1%
- Huatë 5%
- Kapitali dhe aksionet/kuotat e fondit të investimit 11%
- Llogari të tjera të pagueshme 1%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

